



Dyzet hadithe
për
PRINDERIT

Tiranë, 2015

Titulli: Dyzet hadithe për prindërit

Përktheu dhe përshtati: Sabrie Feza

Recensent: Vullnet Merja

Redaktoi: Liseda Ramaj

Përkujdesja kompjuterike & Kopertina:

Sabrie Feza

Botoi: Fondacioni i Kur'anit - Tiranë

Dyzet hadithe për

Edhe pse ekzistenca jonë është prej Allahut, vetë Zoti i vendosi prindërit shkak të jetës dhe të ekzistencës sonë. Ne jemi dega e ekzistencës së këtyre dy të dashurve dhe frutave nga kopshti i dashurisë, i edukimit, i mirësisë dhe i dhembshurisë së pafund të nënës dhe babait.

Njeriu harron. Kur ai arrin në një moshë të rritur, harron fëmijërinë e tij. Ai harron babain dhe nënën e tij, të cilët me mundime të shumta e rritën atë. E, ç'është më e keqe se sa mosfalënderimi dhe mohimi? Njerëzimi dhe etika na thotë që ne të jemi ndjekës të këtyre dy xhevahirëve dhe t'i bëjmë ata krenarë për ne.

Prindërit

Ne jemi pasqyra e prindërve tanë dhe fëmijët tanë do të jenë pasqyra jonë. Ashtu siç do të sillemi ne me prindërit tanë, ashtu do të sillen edhe fëmijët tanë me ne. Ne jemi burimi ku fëmijët mësojnë. Pra, ç' do të bëjmë, do të gjejmë. Ne duhet të jemi mirënjohës, falënderues dhe të sjellshëm ndaj prindërve. Kështu do të jenë edhe fëmijët tanë.

Është e vërtetë se ne nuk mund t'ua shpërblejmë, madje as t'i falënderojmë ata për mundimet e tyre, ashtu sikurse dhe nuk mundemi t'ia japim hakun Allahut për mirësitë që na ka dhënë. Ne vetëm duhet që të mbyllim gojën, të mos jemi kryelartë dhe të përulemi përpara atyre dy melekëve.

Dyzet hadithe për

Gjithësesi, rëndësinë dhe pozitën e nënës dhe babait ua jep Allahu. Ai është që e shpërblen më së miri të drejtën e secilit. Thëniet që kemi mbledhur në këtë libërth na mësojnë për detyrat që kemi kundrejt prindërve tanë. Allahu na mundësoftë që të jemi prej atyre që u bëjnë mirë prindërve që ata të jenë të kënaqur prej nesh, sepse kënaqësia e tyre është edhe kënaqësia e Allahut.

O Zoti ynë! Na bëj prej atyre që ua dinë rëndësinë mundimeve të prindërve!
O Zoti ynë! Ma mundëso që të rrisim breza me besim në Ty, të bindur, mirënjohës, të edukuar, të pastër dhe vepërmirë.

Prindërit

Hadithi 1

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَنْ حَجَّ عَنْ
وَالِدَيْهِ أَوْ قَضَى عَنْهُمَا مَغْرَمًا بَعَثَهُ اللَّهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ مَعَ
الْأَبْرَارِ

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Ai që e kryen haxhin me nijet për prindërit e tij ose shlyen borxhet e tyre, Allahu, në Ditën e Ringjalljes, do ta Ringjallë me vepërmirët."

Dyzet hadithe për

Hadithi 2

قَالَ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ : أَفْضَلُ الْأَعْمَالِ الصَّلَاةُ
لَوْفَتْهَا، وَبُرُّ الْوَالِدَيْنِ وَالْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Veprat më të mira të adhurimit janë:

- 1- Namazi në kohën e tij;
- 2- Mirësia ndaj nënës dhe babait;
- 3- Lufta në rrugën e Allahut.

Prindërit

Hadithi 3

...فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ : فَقَرَّ مَعَ
وَالِدَيْكَ فَوَالَّذِي نَفْسِي بِيَدِهِ لَا نُسُحُمَا بِكَ يَوْمًا وَلَيْلَةً
خَيْرٌ مِنْ جِهَادِ سَنَةٍ .

Një burrë shkoi tek Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha: "Kam nënën dhe babain të moshuar të cilët për shkak të lidhjes së ngushtë dhe dashurisë ndaj meje, nuk më lejojnë që të shkoj në luftë." Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin

Dyzet hadithe për
mbi të dhe mbi familjen e tij!) i tha: "Qëndro
pranë prindërve të tu. Betohem në Atë që
ka dorën e Tij shpirtin tim se lidhja e tyre
me ty është më e mirë se lufta njëvjeçare.

Prindërit

Hadithi 4

عَنْ ابْنِ مَسْعُودٍ قَالَ: سَأَلْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَ

آلِهِ: أَيُّ الْأَعْمَالِ أَحَبُّ إِلَى اللَّهِ عَزَّوَجَلَّ؟ قَالَ: الصَّلَاةُ

لَوْفَتْهَا، قُلْتُ ثُمَّ أَيُّ شَيْءٍ؟ قَالَ: بِرُّ الْوَالِدَيْنِ، قُلْتُ: ثُمَّ

أَيُّ شَيْءٍ؟ قَالَ: الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ

Ibn Mesud ka thënë: "E pyeta Profetin e nderuar (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se cila është

Dyzet hadithe për
vepra më e detyruar tek Allahu."
*Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të
dhe mbi familjen e tij!) tha:*

- Namazi në kohën e tij.

I thashë: -Po pas tij?

Tha: - Mirësia ndaj nënës dhe babait.

I thashë përsëri: - Po pas saj?

Tha: - Lufta në rrugën e Allahut.

Prindërit

Hadithi 5

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَا وَلَدٌ بَارٌّ نَظَرَ إِلَى
أَبَوَيْهِ بِرَحْمَةٍ إِلَّا كَانَ لَهُ بِكُلِّ نَظْرَةٍ حِجَّةٌ مَبْرُورَةٌ فَقَالُوا: يَا
رَسُولَ اللَّهِ وَإِنْ نَظَرَ فِي كُلِّ يَوْمٍ مِائَةَ نَظْرَةٍ؟ قَالَ: نَعَمْ اللَّهُ
أَكْبَرُ وَأَطْيَبُ

Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)
ka thënë: "Çdo fëmijë vepërmirë, i cili e shikon nënën dhe babain e tij me mëshirë,

Dyzet hadithe për

ka shpërblim sa një haxh i pranuar.

E pyetën: Edhe nëse ai i shikon ata njëqind herë në ditë?

Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: Po. Allahu është më i Madh dhe i Pastër."

Hadithi 6

عَنْ أَبِي الْحُسَيْنِ الرِّضَا عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: إِنَّ اللَّهَ عَزَّوَجَلَّ
أَمَرَ بِثَلَاثَةٍ مَقْرُوءٍ بِهَا ثَلَاثَةٌ أُخْرَى: أَمَرَ بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ،
فَمَنْ صَلَّى وَلَمْ يُزَكِّ لَمْ تُقْبَلْ مِنْهُ صَلَاتُهُ وَأَمَرَ بِالشُّكْرِ لَهُ
وَلِلْوَالِدَيْنِ، فَمَنْ لَمْ يَشْكُرْ وَالِدَيْهِ لَمْ يَشْكُرِ اللَّهَ، وَأَمَرَ
بِاتِّقَاءِ اللَّهِ وَصِلَةِ الرَّحِمِ، فَمَنْ لَمْ يَصِلْ رَحِمَهُ لَمْ يَتَّقِ اللَّهَ
عَزَّوَجَلَّ.

Imam Rizai (*paqja qoftë mbi të!*) ka treguar
se Allahu ka thënë që tre gjëra të

Dyzet hadithe për

veprohen bashkë me tre gjëra të tjera:

1- Ka urdhëruar për namazin dhe zekatin.

Kështu që, nëse dikush e fal namazin dhe nuk e jep zekatin, namazi i tij nuk pranohet.

2- Ka urdhëruar që ta falënderojnë Atë dhe prindërit. Kështu që, ai i cili nuk i falënderon prindërit, nuk e ka falënderuar as Allahun.

3- Ka urdhëruar në devotshmëri dhe ruajtjen e lidhjeve farefisnore. Kështu që, ai i cili nuk i ruan lidhjet farefisnore, nuk ka vepruar as me devotshmëri.

Prindërit

Hadithi 7

قَالَ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ : بُرُّ الْوَالِدَيْنِ مِنْ حُسْنِ مَعْرِفَةِ
الْعَبْدِ بِاللَّهِ إِذَا لَا عِبَادَةَ أَسْرَعُ بُلُوغًا بِصَاحِبِهَا إِلَى رِضَى
اللَّهِ مِنْ حُرْمَةِ الْوَالِدَيْنِ الْمُسْلِمِينَ لِوَجْهِ اللَّهِ تَعَالَى

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"T'i bësh mirë nënës dhe babait është
shenjë e përljes ndaj Allahut, sepse asnjë
lloj adhurimi nuk mbërrin më shpejt te
kënaqësia e Allahut se sa nderi i nënës
dhe i babait mysliman për hir të Allahut."

Dyzet hadithe për

Hadithi 8

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَنْ أَصْبَحَ مُطِيعًا لِلَّهِ
فِي الْوَالِدَيْنِ أَصْبَحَ لَهُ بَابَانِ مَفْتُوحَانِ مِنَ الْجَنَّةِ وَإِنْ كَانَ
وَاحِدًا فَوَاحِدًا .

Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Atij, që i bindet urdhrit të Allahut për prindërit, do t'i hapen dy dyer në Xhenet. E nëse ka njërin prind, atëherë do të ketë një derë."

Prindërit

Hadithi 9

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: الْعَبْدُ الْمُطِيعُ
لِوَالِدَيْهِ وَلِرَبِّهِ فِي أَعْلَى عِلِّيِّينَ

Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Robi që i bindet prindërve dhe Zotit të tij, në Ditën e Gjykimit, do të ketë vendin më të lartë."

Dyzet hadithe për

Hadithi 10

قَالَ أَمِيرُ الْمُؤْمِنِينَ عَلِيُّ عَلَيْهِ السَّلَامُ : بِرُّ الْوَالِدَيْنِ أَكْبَرُ
فَرِيضَةٍ .

Imam Aliu (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Detyrë e madhe është t'u bësh mirë
prindërve."

Prindërit

Hadithi 11

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَنْ أَرْضَى وَالِدَيْهِ
فَقَدْ أَرْضَى اللَّهَ وَمَنْ آسَخَطَ وَالِدَيْهِ فَقَدْ آسَخَطَ اللَّهَ

Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Ai që i lumturon prindërit, ka lumturuar Allahun. Ai që i zemëron prindërit, ka zemëruar Allahun."

Dyzet hadithe për

Hadithi 12

عَنْ الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: بَيْنَا مُوسَى بْنُ عِمْرَانَ
يُنَاجِي رَبَّهُ عَزَّوَجَلَّ إِذْ رَأَى رَجُلًا تَحْتَ عَرْشِ اللَّهِ عَزَّوَجَلَّ
فَقَالَ: يَا رَبِّ مَنْ هَذَا الَّذِي قَدْ أَظْلَعَهُ عَرْشُكَ؟ فَقَالَ: هَذَا
كَانَ بَارًّا بِوَالِدَيْهِ، وَلَمْ يَمْشِ بِالنَّمِيمَةِ

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Kur hazreti Musai (*paqja qoftë mbi të!*)
ishte në përgjërim ndaj Allahut, pa një
burrë nën hijen e Arshit të Allahut dhe në

Prindërit

mirësitë e Tij. Ai (Musai) tha: - O Zoti im!
Kush është ky, që po rri nën hijen e Arshit
Tënd?

Allahu tha: - Ai ishte vepërmirë ndaj
prindërve të tij dhe kurrë nuk bënte
shpifje. "

Dyzet hadithe për

Hadithi 13

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: سِرٌّ سَتَيْنِ
بِرِّوَالِدَيْكَ، سِرٌّ سَنَةٌ صِلَ رَحِمَكَ

Profeti i nderuar (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Ec dy vjet për t'i bërë mirë prindërve të tu. Ec një vit për të ruajtur lidhjet farefisnore. (Nëse prindërit janë aq larg sa të duhet të ecësh dy vjet për t'u bërë mirë, sërish ia vlen.)"

Prindërit

Hadithi 14

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَنْ أَحَبَّ أَنْ يُمَدَّلَهُ
فِي عُمْرِهِ وَأَنْ يُزَادَ فِي رِزْقِهِ فَلْيَبِرَّ وَالِدَيْهِ وَلْيَصِلْ رَحْمَهُ .

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Ai që dëshiron që t'i shtohet jeta dhe risku (furnizimi), le t'u bëjë mirë prindërve dhe të ruajë lidhjet farefisnore."

Dyzet hadithe për

Hadithi 15

عَنْ حَنَّانِ بْنِ سُدَيْرٍ قَالَ : كُنَّا عِنْدَ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ
السلامَ فِينَا مُيَسَّرٌ فَذَكَرُوا صَلَاةَ الْقَرَابَةِ فَقَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ
عليه السلام: يَا مُيَسَّرُ قَدْ حَضَرَ أَجْلُكَ غَيْرَ مَرَّةٍ
وَلَا مَرَّتَيْنِ، كُلْ ذَلِكَ يُؤَخِّرُ اللَّهُ أَجَلَكَ، لِصَلَاتِكَ قَرَابَتِكَ،
وَإِنْ كُنْتَ تُرِيدُ أَنْ يُزَادَ فِي عُمرِكَ فَبِرِّ شَيْخِيكَ يَعْنِي
أَبَوَيْكَ .

Prindërit

Hanan bin Sudeir ka thënë: "Ishim në prani të imam Sadikut (*paqja qoftë mbi të!*). Aty ishte edhe Mujessiri. Ra fjala tek lidhja farefisnore dhe imami (*paqja qoftë mbi të!*) tha: - O Mujessir! Sa herë ka ardhur vdekja tek ti, por për hir të ruajtjes së lidhjeve farefisnore, Allahu e ka sprapsur atë! Nëse dëshiron që Allahu të ta zgjasë jetën, atëherë bëji mirësi prindërve të tu."

Dyzet hadithe për

Hadithi 16

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ : جَاءَ رَجُلٌ إِلَى النَّبِيِّ
صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ فَقَالَ : يَا رَسُولَ اللَّهِ مَنْ أَبِي؟ قَالَ :
أُمُّكَ، قَالَ : ثُمَّ مَنْ؟ قَالَ : أُمُّكَ، قَالَ : ثُمَّ مَنْ؟ قَالَ :
أُمُّكَ، قَالَ : ثُمَّ مَنْ؟ قَالَ : أَبَاكَ .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*)
transmeton se një burrë shkoi te Profeti
(*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*
dhe mbi familjen e tij!) dhe i tha: - O i

Prindërit

Dërguar i Allahut! Kujt t'i bëj mirë?

Profeti i tha: - Nënës tënde.

Burri pyeti: Po pas saj, kujt t'i bëj mirë?

Profeti i tha: - Nënës tënde.

Burri: - Po pas saj?

Profeti: - Nënës tënde.

Burrë përsëri pyeti: - Po pas saj, kujt tjetër?

Profeti i tha: - Babait tënd.

Dyzet hadithe për

Hadithi 17

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ قَالَ: بُرُّوا آبَاءَكُمْ
يَبْرُكْكُمْ أَبْنَاءُكُمْ، عَقُّوا عَنْ نِسَاءِ النَّاسِ تُعَفُّ نِسَائُكُمْ .

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Bëjuni mirë prindërve që edhe ata t'ju bëjnë mirë juve. Mbyllini sytë ndaj grave të të tjerëve që të tjerët të mbyllin sytë ndaj grave tua.".

Hadithi 18

عَنْ أَبِي الْحَسَنِ مُوسَى عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ : سَأَلَ رَجُلٌ
رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ : مَا حَقُّ الْوَالِدِ عَلَى
وَلَدِهِ؟ قَالَ : لَا يُسَمِّيهِ بِاسْمِهِ ، وَلَا يَمْشِي بَيْنَ يَدَيْهِ ، وَلَا يَجْلِسُ
قَبْلَهُ وَلَا يَسْتَسِيبُ لَهُ

Është transmetuar nga imam Kadhimi
(paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: “Një burrë
e ka pyetur të Dërguarin e Allahut (paqja
dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi

Dyzet hadithe për

familjen e tij!): - Cila është e drejta e fëmijës ndaj prindërve të tij? Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është përgjigjur:

- 1- Ata të mos i thërrasë në emër;
- 2- Në rrugë të mos ecin para tyre;
- 3- Të mos ulen para se të ulen ata;
- 4- Të mos bëjë ndonjë vepër që njerëzit t'i shajnë prindërit e tij."

Prindërit

Hadithi 19

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ :
نَظَرُ الْوَلَدِ إِلَى
وَالِدَيْهِ حُبًّا هُمَا عِبَادَةٌ .

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed
(*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të
dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Shikimi
me dashuri i nënës dhe i babait nga fëmija
i tyre është adhurim."

Dyzet hadithe për

Hadithi 20

عَنْ أَبِي وَلَادٍ الْحَنَاطِ قَالَ : سَأَلْتُ أَبَا عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ
السلام عَنْ قَوْلِ اللَّهِ : «وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا» فَقَالَ :
الْإِحْسَانُ أَنْ تُحْسِنَ صُحْبَتَهُمَا وَلَا تُكَلِّفَهُمَا أَنْ يَسْأَلَكَ
شَيْئًا هُمَا يَحْتَاجَانِ إِلَيْهِ .

Ebi Velad ka thënë: “E pyetëm imam Sadikun (*paqja qoftë mbi të!*) për kuptimin e ajetit 83 të sures “Bekare” ku thuhet: "... *t'u bëjnë mirë prindëroë...*" Ai u përgjigj:

Prindërit

T'u bësh mirë prindërve do të thotë që sjelljen tënde ndaj tyre ta bësh të mirë dhe të mos i detyrosh që të kërkojnë prej teje atë që kanë nevojë."

Dyzet hadithe për

Hadithi 21

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ : لَا تَمْلَأُ عَيْنَيْكَ مِنَ النَّظَرِ
إِلَيْهِمَا إِلَّا بِرَحْمَةٍ وَرِقَّةٍ، وَلَا تَرْفَعْ صَوْتَكَ فَوْقَ أَصْوَاتِهِمَا،
وَلَا يَدَيْكَ فَوْقَ أَيْدِيهِمَا وَلَا تَتَقَدَّمْ قُدَّامَهُمَا .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Mos i ngrysni sytë tuaj para prindërve,
vetëm se prej dhembshurisë dhe mëshirës.
Mos e ngrini zërin mbi zërin e tyre. Mos e
ngreni dorën mbi dorën e tyre dhe mos
ecni në rrugë para tyre."

Prindërit

Hadithi 22

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ: مَا يَمْنَعُ الرَّجُلَ مِنْكُمْ أَنْ يَبِرَّ
وَالِدَيْهِ حَيَّيْنِ أَوْ مَيِّتَيْنِ، يُصَلِّيَ عَنْهُمَا وَيَتَصَدَّقَ عَنْهُمَا
وَيَحِجَّ عَنْهُمَا وَلَهُ مِثْلُ ذَلِكَ، فَيَزِيدُهُ اللَّهُ (عَزَّوَجَلَّ) بِرِّهِ
وَصَلَاتِهِ خَيْرًا كَثِيرًا

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Çfarë pengese i bëhet një personi që t'u
bëjë mirë prindërve të tij, gjallë apo

Dyzet hadithe për
vdekur qofshin ata?! Ndërkohë që mundet, që me nijet për ta, të falë namaz, të japë sadaka, të kryejë haxhin dhe të agjërojë. Nëse ai vepron kështu, shpërblimet u shkojnë atyre (prindërve) dhe njëkohësisht, po aq shpërblime i jepen edhe vetë atij. Përveç kësaj, Allahu për shkak të veprave të mira dhe namazit, i shton mirësitë ndaj tij."

Prindërit

Hadithi 23

عَنْ أَبِي جَعْفَرٍ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: ثَلَاثٌ لَمْ يَجْعَلِ اللَّهُ
(عَزَّوَجَلَّ) لِأَحَدٍ فِيهِنَّ رُخْصَةً آدَاءُ الْأَمَانَةِ إِلَى الْبَرِّ
وَالْفَاجِرِ وَالْوَفَاءُ بِالْعَهْدِ لِلْبَرِّ وَالْفَاجِرِ وَبِرُّ الْوَالِدَيْنِ بَرَّيْنِ
كَانَا أَوْ فَاجِرَيْنِ .

Imam Bakiri (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

"Allahu nuk i ka dhënë leje askujt për
lënien e tre gjërave:

- 1- Dhënia e amanetit burrit të mirë
dhe atij të shthurur.

Dyzet hadithe për

2- Mbajtja e besës dhe e premtimit ndaj të mirit dhe të keqit.

3- Bërja mirë ndaj prindërve të mirë apo të këqinj qofshin ato."

Prindërit

Hadithi 24

كَتَبَ الرِّضَا عَلَيْهِ السَّلَامُ لِلْمَأْمُونِ : بُرِّ الوَالِدَيْنِ وَاجِبٌ،
وَإِنْ كَانَا مُشْرِكَيْنِ وَلَا طَاعَةَ لَهُمَا فِي مَعْصِيَةِ الْخَالِقِ

Imam Rizai (*paqja qoftë mbi të!*) në një shkrim drejtuar Ma'munit thotë: "T'u bësh mirë prindërve është e detyrueshme edhe nëse ata janë mushrikë dhe mohues. Por nëse ata të urdhërojnë që të veprosh kundër Allahut, nuk duhet t'u bindesh atyre."

Dyzet hadithe për

Hadithi 25

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ قَالَ: مَنْ زَارَ قَبْرَ
وَالِدَيْهِ أَوْ أَحَدِهِمَا فِي كُلِّ جُمُعَةٍ مَرَّةً غُفِرَ لَهُ وَ كَتَبَ بِرًّا

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed
(*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të
dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
"Ai që e viziton varrin e nënës dhe të
babait ose njërit prej tyre, në çdo ditë të
xhuma, Allahu e fal atë dhe e shkruan prej
vepërmirëve."

Prindërit

Hadithi 26

عَنْ أَبِي الْحَسَنِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى
اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: كُنْ بَارًا وَاقْتَصِرْ عَلَى الْجَنَّةِ وَإِنْ كُنْتَ
عَاقًا فَاقْتَصِرْ عَلَى النَّارِ .

Është transmetuar nga imam Rizai (*paqja qoftë mbi të!*) se i Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

"Ji vepërmirë ndaj nënës dhe babait tënd që Xheneti të jetë i yti. Por nëse do të bëhesh i padëgjueshëm ndaj tyre do të bëhesh banues i Xhehenemit."

Dyzet hadithe për

Hadithi 27

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ : لَوْ عَلِمَ اللَّهُ شَيْئًا
أَدْنَى مِنْ أَفٍّ لَنَهَى عَنْهُ، وَهُوَ مِنْ أَدْنَى الْعُقُوقِ وَمِنْ
الْعُقُوقِ أَنْ يَنْظُرَ الرَّجُلُ إِلَى وَالِدَيْهِ فَيُحِدَّ النَّظَرَ إِلَيْهِمَا .

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Nëse do të kishte ndonjë gjë tjetër më të pakët se sa thënia "uf", Allahu do të ndalonte në thënien e saj. "Uf" është thënia më e pakët për t'u bërë mizor. Një nga mënyrat për t'u bërë mizor, është që njeriu të shohë vrenjtur nënën dhe babain e tij."

Prindërit

Hadithi 28

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: مَنْ نَظَرَ إِلَى أَبِيهِ نَظَرَ
مَاقَاتٍ، وَهُمَا ظَالِمَانِ لَهُ، لَمْ يَقْبَلِ اللَّهُ لَهُ صَلَاةً .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Atij që e shikon me mëri nënën dhe
babain që i kanë bërë padrejtësi atij, nuk i
pranohen namazet tek Allahu."

Dyzet hadithe për

Hadithi 29

قَالَ أَمِيرُ الْمُؤْمِنِينَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: مَنْ أَحْزَنَ وَالِدَيْهِ فَقَدْ عَقَّهُمَا .

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:

"Ai që i zemëron prindërit e tij, është bërë mizor (nuk e ka ruajtur të drejtën e tyre)."

Prindërit

Hadithi 30

عَنْ أَبِي جَعْفَرٍ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: إِنَّ أَبِي نَظَرَ إِلَى رَجُلٍ
وَمَعَهُ ابْنُهُ يَمْشِي وَالابْنُ مُتَّكِيٌّ عَلَى ذِرَاعِ الْآبِ، قَالَ:
فَمَا كَلَّمَهُ أَبِي مَقْتًا لَهُ حَتَّى فَارَقَ الدُّنْيَا .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Babai im pa një burrë që ecte me të birin e
tij. Ndërkohë që ecnin, i biri kishte
mbështetur krahun mbi supin e babait.
Kur e pa një sjellje të tillë, nuk i foli më atij
(djali) nga mërzia që kishte ndaj tij."

Dyzet hadithe për

Hadithi 31

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ : ثَلَاثَةٌ مَنْ عَارَظَهُمْ ذَلَّ : الْوَالِدُ
وَالسُّلْطَانُ وَالْغَرِيمُ

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Kushdo që bën konflikt me këto tre vetë
do të nënçmohet: babain, sunduesin e
drejtë dhe borxhliun."

Prindërit

Hadithi 32

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: إِيَّاكُمْ وَعُقُوقَ
الْوَالِدَيْنِ، فَإِنَّ رِيحَ الْجَنَّةِ تُوجَدُ مِنْ مَسِيرَةِ أَلْفِ عَامٍ وَ
لَا يَجِدُهَا عَائِقٌ وَلَا قَاطِعٌ رَحِمَ

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed
(*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të
dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Bëni
kujdes nga mosbindja ndaj prindërve!
Edhe pse aroma e Xhenetit ndihet nga
largësia e një mijë vjetëve, ai që është i
padëgjueshëm ndaj prindërve dhe
shkëput lidhjet me farefisën, nuk do e
ndiejë atë aromë. (Pra, largësia e tij me
Xhenetin do të jetë një mijë vjet.)"

Dyzet hadithe për

Hadithi 33

عَنِ الصَّادِقِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ : لَا يَدْخُلُ الْجَنَّةَ الْعَاقُ
لِوَالِدَيْهِ وَ الْمُدْمِنُ الْخَمْرِ وَ الْمَنَّانُ بِالْفِعَالِ لِلْخَيْرِ إِذَا
عَمِلَهُ .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Nuk hyn në Xhenet ai që është i
padëgjueshëm ndaj prindërve, as pijaneci
dhe as ai që bën diçka të mirë për të tjerët
dhe e përmend atë."

Prindërit

Hadithi 34

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: أَرْبَعَةٌ لَا يَنْظُرُ اللَّهُ
إِلَيْهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ، عَاقٌ وَ مَنَّانٌ وَ مُكَذِّبٌ بِالْقَدَرِ وَ مُدْمِنٌ
خَمْرٍ .

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Në Ditën e Kiametit, Allahu nuk do t'i mëshirojë katër grupe: 1- Atë që është i padëgjueshëm ndaj prindërve; 2- Atë që vendos kamatë; 3- Përgënjeshtresin e kzasë dhe kaderit; 4- Pijanecin."

Dyzet hadithe për

Hadithi 35

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: ثَلَاثَةٌ مِنَ الذُّنُوبِ
تُعَجِّلُ عِقُوبَتَهَا وَلَا تُؤَخَّرُ إِلَى الْآخِرَةِ: عُقُوقُ الْوَالِدَيْنِ، وَ
الْبَغْيُ عَلَى النَّاسِ وَكُفْرُ الْإِحْسَانِ

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed
(*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të
dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Dënimi i
tre gjynaheve nuk mbetet për Ditën e
Kiametit (por do të dënohet në këtë botë):
1- Ai që është i padëgjueshëm ndaj
prindërve;
2- Padrejtësia dhe dhunimi i njerëzve;
3- Mosfalënderimi përpara mirësive dhe
të mirave."

Prindërit

Hadithi 36

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: الذُّنُوبُ الَّتِي تَظْلِمُ
الْهَوَاءَ عُقُوبُ الْوَالِدَيْنِ

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Nga gjynahet që e nxijnë dhe e errësojnë
kohën është mosbindja ndaj prindërve."

Dyzet hadithe për

Hadithi 37

قَالَ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ :عُقُوقُ الْوَالِدَيْنِ مِنَ الْكِبَائِرِ
لِإِنَّ اللَّهَ (عَزَّوَجَلَّ) جَعَلَ الْعَاقَّ عَصِيًّا شَقِيًّا .

Imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Mosbindja ndaj prindërve është nga
gjynahet e mëdha, sepse Allahu i
Madhëruar e ka quajtur gjynah dhe
fatkeqësi të madhe mosbindjen ndaj
prindërve.”

Hadithi 38

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ: إِنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ حَضَرَ شَابًّا عِنْدَ وَفَاتِهِ فَقَالَ لَهُ: قُلْ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، قَالَ: فَأَعْتَقَلَ لِسَانَهُ مَرَارًا فَقَالَ لِامْرَأَةٍ عِنْدَ رَأْسِهِ: هَلْ لِهَذَا أُمٌّ؟ قَالَتْ: نَعَمْ أَنَا أُمُّهُ، قَالَ: أَفَسَاخِطَةٌ أَنْتِ عَلَيْهِ؟ قَالَتْ: نَعَمْ مَا كَلَّمْتُهُ مُنْذُ سِتِّ حِجَجٍ، قَالَ لَهَا: إِرْضِي عَنْهُ، قَالَتْ: رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ بِرِضَاكَ يَا رَسُولَ اللَّهِ: فَقَالَ لَهُ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: قُلْ: لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ قَالَ: فَقَالَهَا ... ثُمَّ طَفَى

Dyzet hadithe për

Transmetohet se imam Sadiku (*paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur po ndërronte jetë një i ri, Profeti (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndodhej pranë shtratit të tij e i tha: - Thuaj: “La ilahe ilaAllah”. Goja e të riut i ishte lidhur. Profeti e përsëriti disa herë, por goja nuk i erdhi. Profeti (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha gruas, e cila i qëndronte pranë të riut: - A ka nënë ky i ri? Gruaja tha: Po, unë jam nëna e tij. Profeti e pyeti: -A je e pakënaqur prej tij? Gruaja u përgjigj: Po, ka gjashtë vjet që nuk flas me të. Profeti i tha: -Ji e kënaqur prej tij. Gruaja tha: - O i Dërguar i Allahut, unë jam e kënaqur për hir të Allahut dhe hatrin tënd (unë e fala atë). Pastaj Profeti (*paqja dhe bekimet e*

Prindërit

Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)
ia përsëriti edhe një herë djalit që të
thoshte "La ilahe ilaAllah". Atëherë, djali
hapi gojën e tha "La ilahe ilaAllah", e më
pas, vdiq.

Dyzet hadithe për

Hadithi 39

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: يُقَالُ لِلْعَاقِ إِعْمَلْ
مَا شِئْتَ فَإِنِّي لَا أَعْفِرُ لَكَ وَيُقَالُ لِلْبَارِّ إِعْمَلْ مَا شِئْتَ
فَأِنِّي سَأَعْفِرُكَ .

Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Mosrespektuesit të prindërve (nga ana e Allahut) i thuhet: Bëj ç’të duash, ty nuk do të të fal. Vepërmirit (ndaj prindërve) i thuhet: Vepro ç’të duash, ty të kam falur.”

Hadithi 40

قَالَ عَلِيُّ بْنُ الْحُسَيْنِ عَلَيْهِ السَّلَامُ: جَاءَ رَجُلٌ إِلَى النَّبِيِّ
صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ فَقَالَ: يَا رَسُولَ اللَّهِ مَا مِنْ عَمَلٍ
قَبِيحٍ إِلَّا قَدْ عَمِلْتُهُ فَهَلْ لِي تَوْبَةٌ؟ فَقَالَ لَهُ رَسُولُ اللَّهِ
صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: فَهَلْ مِنْ وَالِدَيْكَ أَحَدٌ حَيٌّ؟ قَالَ:
أَبِي: قَالَ: فَادْهَبْ فَبِرَّهُ قَالَ: فَلَمَّا وَلَّى قَالَ رَسُولُ اللَّهِ
صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: لَوْ كَانَتْ أُمُّهُ .

Imam Sexhad (*paqja qoftë mbi të!*) ka transmetuar: “Një burrë vajti te Profeti (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e i tha: - O i Dërguar

Dyzet hadithe për
i Allahut! Për mua nuk ka mbetur asnjë
vepër e keqe, të cilën nuk e kam vepruar.
A mundem që të pendohem? Profeti i
Allahut (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin
mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: A e ke
ndonjërin prej prindërve të gjallë? Tha: Po,
babain. Profeti tha: Shko, e bëji mirë atij,
(që të falesh). Kur burri u nis për në
shtëpi, Profeti tha: “Ah sikur të kishte
nënë gjallë!”. (Nëse do të kishte nënë
gjallë e t’i bënte asaj mirë, ai do të falej më
shpejt.)”